REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA LUSHNJE

Nr 9247 Prot.

Lushnje, më 20/10/2025

PROJEKT- VENDIM

NR. 97 DATË 20/10/2025

PËR

"MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS " KONGRESI ARSIMOR LUSHNJE" LAGJIA "ÇLIRIM" NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.1 ,BASHKIA LUSHNJE"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur, në mbështetje të nenit 8 pika 2,nenit 9,pika 1.7,shkronja "b" nenit 54 shkronja "ll" të Ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar; si dhe neni 2 pika 1 gërma (ç),neni 3,neni 5 pika 1, neni 7, neni 25, neni 26 pika 1, neni 30 të Ligjit Nr.9270, datë 29.7.2004 "Për sistemin e adresave "(Ndryshuar me Ligjin nr.9951, datë 10.7.2008, Ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016) (i përditësuar). Ligjit nr,107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimine territorit" i ndryshuar. VKB-së Lushnje me nr.63 datë 17.11.2009 JU:

PROPOZOJMË:

I. Miratimin e emërtimit të rrugës **" Kongresi Arsimor Lushnje"** Lagjia "Çlirim" Njësia Administrative nr.1 ,Bashkia Lushnje nga " Shëtitorja e Palmave" deri në rrugën "Azem Qyka" sipas planvendosjes bashkëngjitur projekt vendimit.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërrmarrja e Pasurisë Publike,Drejtoria e Shërbimeve Publike.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT

Ariola Beqo

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
QENDRA KULTURORE DHE KLUBI I SPORTIT

Nr.224 Prot.

Lushnjë më, 03/09/2025

Lënda: Kërkesë mbi emërtimin e rrugës së re anës përroit të qytetit të Lushnjes

Drejtuar: KRYETARES SË BASHKISË LUSHNJE
Znj. Eriselda Sefa

Duke marrë shkas nga investimi i rëndësishëm i bërë në të dyja anët e përroit që kalon përmes qytetit të Lushnjes dhe nga verifikimimet e bëra rezulton se rruga e re e krijuar së fundmi nuk ka emër. Propozojmë që kjo rrugë të marrë këtë emër: ***"Kongresi Arsimor i Lushnjes-1920"***. Kjo për arsye se siç dihet pranë rrugës së re ka egzistuar shkolla plotore e Lushnjës, e njohur në zhargonin vendas si shkolla e përroit, ku më 15 Gusht të vitit 1920 zhvilloj punimet Kongresi Kombëtar i Arsimit. I pari pas shpalljes së Pavarësisë. Ky kongres shëbeu si një rreze shprese për çështjet që lidheshin me arsimin. Duke pare rëndësinë që kishte ky kongres dhe vendi është pikërisht në këtëvend, kërkojmë që rruga e re të marrë emrin e Kongresit Arsimor i Lushnjes. Për më shumë po ju bashkangjis aktivitetin e tij historik.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Konc.:*Niko Ferro*

DREJTORIA E Q.K.K.S. LUSHNJE
Brizida Dervishi

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKI A LUSHNJE

Nr8247 Prot.

Lushnje, më 20/10/2025

RELACION

PËR

"MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË RRI GËS " KONGRESI ARSIMOR LUSHNJE" LAGJIA "ÇLIRIM" NJËSIA ADMINIS TRATIVE NR.1 ,BASHKIA LUSHNJE"

Drejtuar:Këshillit Bashkiak

Të nderuar: Këshilltare/Këshilltarë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.9270 "Për sistemin e adresave" i përditësuar, lind nevoja për ëmertimin e rrugëve të pa emërtuar në Bashkinë Lushnje. Bashkia Lushnje në investimin që ka kryer për projektin "Rehabilitimi i përroit dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij" ka krijuar dhe një rruge të re të ndodhur përgjatë përroit. Kjo rrugë fillon nga rruga "Shëtitorja e Palmave" dhe përfundon në rrugën "Azem Quka në lagjen "Çlirim", Njësia Administrative nr.1 , Bashkia Lushnje. Institucioni i Bashkisë Lushnje në përmbushje të detyrimeve të ligjit për pushtetin vendor i propozon Këshillit Bashkiak që të bëjë emërtimin e kësaj rrug e.

Bashkia Lushnje referuar fakteve historike të qytetit dhe rëndësisë së madhe që kanë pasur ato **i propozon** Këshillit Bashkiak emërtimin e rrugës në **"Kongresi Arsimor Lushnje".**

Referuar historikut të qytetit pranë rrugës së re ka egzistuar shkolla plotore (fillore) e Lushnjes, ku më 15 gusht të vitit 1920 mbajti punime Kongresi Kombëtar i Arsimit.Ky ishte kongresi i pare i këtij lloji pas shpalljes së pavarsisë. Në këtë kongres u diskutua gjerësisht problemi i nxjerrjes së një të përkohëshmeje pedagogjike për shkollën shqipëtare, e domosdoshme për kohën.Në kongres u vendos për nxjerrjen e një reviste, ku të gjenin pasqyrimin e plotë si anët teorike, ashtu dhe ato praktike të arsimit .

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+35 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Kongresi Arsimor i Lushnjës vendosi:

1. Shkolla fillore në qytet të ishin me 5 (pesë) klasa,ndërsa në fshat 3 (tre).
2. Miratoi programin sintetik për shkollën fillore e qytetëse, programin analitik të përjavshëm.
3. U miratuan 219 terma për gjuhën, aritmetikën e gjeometrinë, gjithashtu u shkruan modelet e orareve, dëshmive shkollore, amzave, regjistrave të përditshëm e përjavshëm.
4. U vendos që prej klasës së III fillore të mësohej edhe një gjuhë e dytë që të caktohej nga MASH etj.

Kongresi Arsimor Lushnje ndihmoi shkollat për organizimin e arsimit në vitet 1920-1921, unifikoi programet arsimore, përgatitjen dhe përdorimin e barabartë të dokumentave shkollorë etj. Programet arsimore të nxjerra nga kongresi shërbyen si pikë referimi në arsimin shqiptar edhe për shumë vite në vazhdim.Kongresi Arsimor i Lushnjes pati një rëndësi të madhe. Ai dha ndihmesë në luftë kundër analfabetizmit që kishte pllakosur gjithë vendin.

Faleminderit për mirëkuptimin !

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com